

Tiranë, më 10 Gusht 2022

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

SUBJEKT AUDIOVIZIV PËR TRANSMETIMIN E NJË SPOTI TELEVIZIV NDËRGJEGJËSUES DHE INFORMUES MBI ROLIN E KUVENDIT DHE PËRFSHIRJEN E TË RINJVE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në kuadër të implementimit të grantit të akorduar në zbatim të projektit “Për mbështetjen e Kuvendit dhe Edukimit Qytetar (PACEP)”, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e zbatuar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan (NDI), shpall thirrjen për angazhimin e një subjekti audioviziv për transmetimin e një spot televiziv ndërgjegjësuës dhe informues mbi rolin e Kuvendit në raport me të rinjtë, si dhe përfshirjen e të rinjve në ditët e hapura të realizuara me pjesëmarrjen e deputetëve.

Spoti televiziv i cili do të transmetohet ka një sekuençë gjatësie kohore **prej 13:01 minuta**.

Subjekti duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- Televizioni duhet të jetë televizion kombëtar ose të ketë shtrirje të shikueshmërisë në shumicën e qyteteve të vendit;

KShH inkurajon subjektet tregater/individët e interesuar që të dërgojnë në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së office@ahc.org.al, deri në datën 19 Gusht 2022, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Ofertën Financiare të firmosur (në lekë me TVSH) për:
 - Transmetimin e videos gjatë periudhës Shtator-Tetor 2022
 - Ofertën financiare për transmetimin 1 herë në ditë në prime time dhe jo prime time;
 - Ofertën financiare për transmetimin disa herë në ditë në prime time dhe jo prime time.
 - Nivelin e shikueshmërisë në prime time dhe jo në prime time.
2. Oferta financiare për secilën kategori duhet të përcaktohet në vlerën financiare për 1 minutë transmetimi.

Në varësi të ofertave të marra, do të realizohet përzgjedhja e mënyrës së transmetimit të videos.

Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin,

Faleminderit,

Me konsideratë,

Komiteti Shqiptar i Helsinkit